

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Mbikqyrja e punimeve konform kontratave të DSHP së në Komunën e Prizrenit**

Sa i përket tenderit për **622-20-530-2-2-1**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

ENG IDEA shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr., Brigada 123"

(Adresa)

Prizren

(Vendi)

+383 49 111 592

(Numri Telefonit)

23000

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

Begir Ramadani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

engidea16@gmail.com

(Adresa elektronike)

23.02.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: **NUK APLIKOHET**

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- B05 Njoftim per Kontrat 19.01.2021
- Proesverballi – 09.02.2021
- NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-18.02.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kemi marr pjesë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP ne

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 21/A Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 61 Tenderet e ulët jashtë Normales

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 64 Dëshmitë e kërkesave

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK duke bere shkelje te dispozitave ligjore te larteshkruara me date 18.02.2021 ka derguar Njoftimin per vendimin e AK te procedures se ketij tenderi. Njekohesisht eshte bashkangjitur edhe Letra standarde per tenderuesin te pasukseshem ne te cilen eshte shkruar si ne vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

AK komuna e Dragashit, komisioni per vleresimin e ofertave nuk ka bere fare zbatimin e LPP duke zgjedh rrugen me te lehte, Shperblen me kontrat ofertuesin em cmimin me te lire dhe shpall 8 ofertuesit e tjere te pasukseshem. Vete vendimi ku perkunder kerkesave mjaft specifike ne dosje te tenderit nxjerr te gjitha OE te pergjeshem eshte e dyshimt dhe po thuaj e pamundur. Mbi te gjitha ajo qe eshte e sigurt ne kete vendim eshte se AK Komuna e Dragashit ka shkelur nenet e lartecekura te LPP-se e sidomos nenin 61. Tenderet e ulët jashtë Normales. Dhenia e kontrates nje Grupi te OE me cmime te tilla eshte degradim i sherbimit te projektimit qe eshte pika fillestare per perdorim te drejte te bugjetit Publik. Nje ofert e till ka premisa te dukshme per te marr sherbime jocilesore dhe nuk arrihet qellimi i ketij aktiviteti te prokurimit qe ne komune e Dragashit eshte deshumar edhe me pare.

Pra, komisioni i vleresimit nuk ka zbatuar Ligjin e Prokurimit dhe nenet e ketij ligji qe perfshihen dhe jane permend em siper. Pra AK ka marr vendim te shperblej me kontart nje OE qe duhej te vleresohej i papergjeshem. OE i shperblyer me kontart nuk permbush kerkesat ne dosjen e tenderit te pershtatshmerise profesionale.

Kjo ankese po behet, jo me shpresen qe do te ndikoj ne permiresimin e kesaj gjendje sot, por me shume qe te mbetet si dokument per gjeneratat e ardhshme (ndoshta i hap e i lexon ndonjeher dikush !).

Nese kerkesa jone per rishqyrtim te vendimit te AK nuk merret ne konsiderate seriosisht, jemi te detyruar qe konfrom nenin 109 te LPP ankesen ta drejtome pran OSHP-se.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet me kete Vendim te AK , jane te shumefishta. Me kete vendim OE ENG IDEA shpk i jane shkaktuar dëme materiale, etike, morale, psikologjik e profesional. Demi material eshte si ne shpenzimet ne pergaditjen e tenderit, kohen qe i eshte kushtuar ketij konkurimi, po ashtu edhe ndikim direkt tek te hyrave te planifikurara dhe aktivitetve profesionale te parapara. Dekurajimi i te gjithë te rinjeve te punesuarve (qe me shume perkushtim kane punuar ne pergaditjen e ofertes) jo vetem ne kompanin tone por edhe me gjere.

Ky veprim thellon krizen dhe rrit zhgenjimin e te rinjeve (qe jane te punesuar ne ndermarrjet tona) te cilet akoma kane mebtur pa migruar nga ky vend qe vetem drejtesi NUK KA.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimit i Vendimit te AKm”.*
- c) një kopje të letrës së tenderuesit te pasuskseshem*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve*